



Datë: 29.10.2025
Numër Protokolli: 7178/2025

A.nr.1444/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Atdhe Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1444/2025 të datës 22.07.2025, të parashtruar nga ankuesi A.E, kundër organit të punësimit: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1444/2025, e datës 22.07.2025, e parashtruar nga ankuesi, A.E.

II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.84/2025, i datës 08.07.2025, i Ministrit në detyrë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

III. Obligohet Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.E(*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi*), më datë 22.07.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4903/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.1444/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.84/2025, të datës 08.07.2025, të Ministrit në detyrë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 12.08.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, ndërsa kjo e fundit më datë 15.08.2025, ka dorëzuar përgjigjen me provat e bashkangjitura të lëndës.

Ndërsa, me datë 29.08.2025, Këshilli po ashtu ka kërkuar prova edhe nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e cila me datë 02.09.2025, ka dorëzuar dokumentet e bashkangjitura. Tutje, Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me Vendimin me numër protokolli 5968/2025, të datës 04.09.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1444/2025, të parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4903/2025, të datës 22.07.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.84/2025 të datës 04.03.2025; Vendimin me Nr.135/2023 të datës 13.07.2023; Aktgjykimin P.A.nr.07/2025 të Gjykatës Supreme të Kosovës; Akt emërimit të datës 01.10.2014; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 15.08.2025; Përshkrimin e detyrave të punës të ankuesit; Kërkesën e datës 29.08.2025; Akt emërimit me Nr.01/2025 të datës 07.07.2025; Përshkrimin e detyrave të punës me numër protokolli 176/2020 të datës 20.01.2020.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit **është e bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 01.10.2014, është i punësuar në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Agjencinë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale. Tutje, sipas shkresave të lëndës, rrjedhë se Ministri në detyrë i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 08.07.2025, ka nxjerrë Vendimin me Nr.84/2025, përmes të cilit z. I.H, me pozitë Drejtor i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore, e ka caktuar Ushtrues të Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale (në tekstin e mëtejme referuar: AMMKM).

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se me vendimin kontestues është shkelur neni 35 paragrafi 2 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ngase është caktuar U.D Drejtor i AMMKM-së një nëpunës nga jashtë institucioni, dhe se me këtë rast është cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e drejta e tij legjitime e pritjes si nëpunës me gradën më të lartë pas Drejtorit. Si rrjedhojë, ankuesi i propozon Këshillit, aprovimin e ankesës, anulimin e Vendimit me Nr.84/2025 të datës 08.07.2025 të Ministrit në detyrë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me obligimin që ky i fundit të nxjerrë vendim dhe ta caktoj të njëjtin në pozitën e U.D Drejtorit të AMMKM-së.

Nga analizimi i shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë, rrjedhë se Ministri në detyrë i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përmes Vendimit me Nr.84/2024 të datës 08.07.2025, ka caktuar Ushtrues Detyrë të Drejtorit të AMMKM-së, z. I.H, i cili sipas Akt emërimit me Nr.01/2025 të datës 07.07.2025, rezulton se mbanë pozitën e kategorisë së mesme drejtuese, atë të Drejtorit të Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe si rrjedhojë e kësaj dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit,

Kolegji i Këshillit, i' u referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i publikuar me datë 02.06.2025 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe i cili ka hyrë në fuqi me datë 17.06.2025, përkatësisht nenit 9, ku përcaktohet se: *1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim:*

1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari. 2. Paragrafi 3. i nenit 35 të Ligjit bazik riformulohet si vijon: 3. “Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se dymbëdhjetë(12) muaj përveç rasteve kur procedura e rekrutimit është shpallur por për arsye objektive pozita nuk është plotësuar”. 3. Paragrafi 4 i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se një periudhë prej dy (2) viteve.; dhe paragrafit 2 të nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se:

Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. Rrjedhimisht, bazuar në nenin 1 të Ligjit Nr. 04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, rezulton se është themeluar Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës si organ i pavarur si dhe përmes tij është përcaktuar statusi, organizimi, funksionimi, detyrat, përgjegjësitë dhe financimi i Agjencisë, ku me nenin 3 përcaktohet se: 1. Agjencia është organ i pavarur për projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale. 2. Agjencia është person juridik dhe për punën e vetë i raporton me shkrim një herë në vit, deri me 31 mars, Kuvendit të Republikës së Kosovës. 3. Nëpunësi i Agjencisë ka statusin e shërbyesit civil. 4. Agjencia ka stemën, e cila përcaktohet me akt nënligjor.....; neni 5 paragrafi 1, ka paraparë se: 1. Agjencia udhëhiqet nga Drejtori, i cili është përgjegjës për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e Agjencisë.; me nenin 6, është përcaktuar procedura e përzgjedhjes së Drejtorit, ku përcaktohej se: 1. Komisioni parlamentar përkatës, gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të Drejtorit të Agjencisë e njofton Kryetarin e Kuvendit për fillimin e procedurës për zgjedhjen e Drejtorit të ri. 2. Komisioni shpall konkursin publik për pozitën e Drejtorit të Agjencisë. Afati për aplikimin e kandidatëve është pesëmbëdhjetë (15) ditë. 3. Kandidati për Drejtor të Agjencisë duhet të plotësojë kushtet si në vijim: 3.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, 3.2. të ketë së paku diplomë universiteti katër (4) vjeçar ose master; 3.3. të mos ketë qenë i dënuar për veprë penale, mbi gjashtë (6) muaj burgim; 3.4. të ketë integritet të lartë moral; 3.5. të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune menaxheriale. 4. Pas skadimit të afatit të paraparë në paragrafin 2. të këtij neni, Komisioni, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili plotëson kushtet e parapara në parafin 3. të këtij neni, për tu zgjedhur Drejtor i Agjencisë, dhe në bazë të rezultatit të intervistës, përgatitë listën e ngushtë me dy (2) kandidatë për votim në Kuvend. 5. Kuvendi, me votim të fshehtë, zgjedh njërin prej dy (2) kandidatëve të propozuar nga Komisioni për Drejtor të Agjencisë, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm. 6. Drejtori i Agjencisë zgjidhet për mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje. 7. Drejtori i Agjencisë, gjatë mandatit, nuk mund të ushtrojë veprimtari politike. 8. Drejtori i Agjencisë, gjatë mandatit, nuk mund të ushtrojë detyra tjera publike, për të cilat shpërblehet me pagesë”, ndërsa me nenin 11 është paraparë se struktura dhe organizimi i Agjencisë rregullohet me akt nënligjor, dhe se nga të dhënat publike në web faqen e këtij institucioni, rezulton se e njëjta ka në fuqi Rregulloren Nr.01/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, e cila është në fuqi nga data 18.10.2019, përmes së cilës është paraparë struktura organizative, e cila është si vijon: Zyra e Drejtorit, Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme dhe Departamenti për Planifikimin, Projektet dhe Menaxhimin e Komplekseve, si dhe Divizionet përkatëse.

Ndërsa, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive të Pavarura, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës e themeluar me Ligjin bazik, është bartur në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Kulturë dhe funksionon si Agjenci Ekzekutive në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, ku si rrjedhojë me nenin 4 dhe 5 të këtij Ligji është përcaktuar se: *Neni 5 i Ligjit bazik, riformulohet si në vijim: Neni 5 Drejtori i Agjencisë 1. Agjencia udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv i cili është përgjegjës për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e Agjencisë. 2. Drejtori i Agjencisë i emëruar sipas nenit 6 të Ligjit bazik, vazhdon të ushtrojë detyrën deri në përfundim të mandatit. 3. Emërimi, shkarkimi, statusi, mandati dhe kohëzgjatja e mandatit, si dhe elementet tjera të marrëdhënies së punës rregullohen me Ligjin përkatës për Zyrtarët Publikë. 4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv, përcaktohen me Ligjin bazik, Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.*

Andaj, Kolegji i Këshillit, bazuar në dispozitat e lartë theksuara ligjore, konstaton se pretendimi i ankimor i ankuesit është i qëndrueshëm, ngase duke marrë për bazë se organi përkatës i punësimit ka strukturën e vet organizative, rrjedhimisht ka dy (2) pozita të kategorisë së mesme drejtuese brenda njësisë së vetë organizative, ku në mesin e tyre përfshihet edhe pozita e ankuesit, ajo e Drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, dhe në kuptim të nenit 35 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, në pozitën e Drejtorit të AMMKM-së, duhej të caktohej zyrtarja/i më i lartë i kategorisë pasuese nga kjo agjenci gjegjësisht do duhej të shfrytëzohen të gjitha mundësit e brendshme për arritjen e këtij qëllimi, detyrimisht do duhej që pozitën e lire të Drejtorit të AMMKM-së, ta mbulonte me njërin nga zyrtarët publik që është me akt emërimi në pozitën e Drejtorit të Departamentit brenda agjencisë përkatëse, e të cilët janë vartës të drejtpërdrejt të Drejtorit të AMMKM-së, sikurse në rastin konkret ku kategoria pasuese e parë e raportimit ndaj kësaj pozite të kategorisë së lartë drejtuese, është pozita e ankuesit: Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, si dhe ajo e Drejtorit të Departamentit për Planifikim, Projekte dhe Menaxhimin e Komplekseve, ndërsa faktikisht në rastin përkatës Ministri në detyrë i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.84/2025 të datës 08.07.2025, për caktimin e U.D Drejtorit të AMMKM-së, ka anashkaluar këto pozita të nivelit të mesëm drejtues brenda AMMK-së, rrjedhimisht ka caktuar një nëpunës nga ministria amë, gjegjësisht jashtë strukturës organizative të kësaj agjencie ekzekutive.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, konstaton se Ministri në detyrë i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.84/2025 të datës 08.07.2025, përkatësisht me caktimin e z.I.H, në pozitën e U.D Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe juridike dhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 35 paragrafin 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 9 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe me nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, prandaj në kuptim të nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i njëjti akt kontestues, rezulton si i paligjshëm dhe si i tillë është shfuqizuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1444/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.E;
- Ministrit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MKRS dhe AMMKM; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.